



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.05.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-369/23, për zyrtarin e lartë z. Naser Balaj, Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për z. Naser Balaj, Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues të rastit), me pretendimin se z. Naser Balaj, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve për Licenca, Autorizime dhe Leje, ka nënshkruar Licenca pa autorizim të Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me shkresën zyrtare me nr. protokolli Dep-06-01/831/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Naser Balaj lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe më pas ka organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me ç'rast zyrtari është njoftuar me pretendimet e raportuesve të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me këtë rast.

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar informacion dhe dokumentacion plotësues nga z. Naser Balaj, përkatësisht menaxhmenti i AKMRrSB-së, të cilin e ka pranuar përmes shkresës zyrtare Dep-06/01-831-1/23.

Nga kërkesa e raportuesve të rastit, takimet e mbajtura me palën, dokumentacioni dhe përgjigjet e siguruara nga z. Naser Balaj dërguar Agjencisë përmes menaxhmentit të AKMRrSB-së, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar gjendjen si në vijim:

“[- Me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të datës 11.06.2018, me nr. prot. 082/2018, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore dhe Ligjin nr. 03/L-189, për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, z. Naser Balaj është caktuar si Kryetar i Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Aplikimeve për Licenca, Autorizime dhe Leje;

- Legjislacioni në fuqi nuk e ka të rregulluar mandatin dhe kohëzgjatjen e komisionit në fjalë përjashtimisht në vendimin e cekur ku përcaktohet se vendimi ka një karakter të përkohshëm dhe si i tillë nuk është shfuqizuar ose zëvendësuar asnjëherë. Legjislacioni përkatës mbi të cilin është mbështetur dhe nxjerrë vendimi i lartcekur nuk e rregullojnë mandatin apo kohëzgjatjen e këtij komisioni;

- Përmes emailit të protokoluar të datës 30.08.2019, Drejtori Përgjithshëm i AKMRrSB, z. B.M. njofton se, ‘...gjatë mungesës së tij në rastet e udhëtimeve eventuale, z. Naser Balaj, Shef i Sektorit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, ushtron detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMRrSB’. z. Balaj gjate periudhave të mungesës sime eventuale është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës në AKMRrSB, si dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive të caktuara për Drejtorin e Përgjithshëm, në pajtim me legjislacionin për Shërbimin civil të Kosovës. Ky autorizim asnjëherë nuk është ndryshuar apo shfuqizuar deri me përfundimin e mandatit të drejtorit të përgjithshëm në shkurt të vitit 2022;

- Si rezultat i përfundimit të mandatit të drejtorit të përgjithshëm paraprak nga detyra e tij dhe deri me ardhjen e drejtorit të përgjithshëm të ri, Komisioni ka vazhduar të kryej punën e tij, përgjatë kësaj periudhe nuk është nënshkruar asnjë licencë në mungesë të personit të autorizuar;

- Gjatë periudhës 01.03.2021-11.05.2023, janë nënshkruar vetëm dy (2) licenca edhe atë në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe me autorizim paraprak të tij. Njëra licencë është nënshkruar me njoftimin dhe konsultimin paraprak me Drejtorin e Përgjithshëm të AKMRrSB-së, i cili nuk ka qenë në Kosovë për arsye shëndetësore, ndërsa subjekti në fjalë është lutur që të trajtohet lënda e tij në afatet ligjore për shkak të mos humbjes së afatit për aplikim për licencën vijuese në Ministrinë e Shëndetësisë. Licenca e cila është nënshkruar nga z. Naser Balaj me autorizim dhe në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk kërkon një vlerësim nga eksperti, sepse licenca ka të bëjë me një pajisje intraorale (për fotografim të dhëmbit), e cila sipas standardeve operuese shëndetësore nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin. Ndërsa nënshkrimi i Licencës tjetër (02.03.2023), me kërkesë të subjektit dhe pas rekomandimit të komisionit për licenca, është bërë gjatë kohës kur zv. Drejtoresha e AKMRrSB-së ishte në pushim vjetor dhe z. Naser Balaj ishte i autorizuar t’i kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, (autorizimi i dërguar në e-mail e datës 23.02.2023;

- ... procesi i licencimit administrohet nga zyrtari i lartë për licenca, i cili në përshkrimin e detyrave të punës e ka kompletimin e kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas Rregullores për autorizime nr. 24/2018, dt. 12.12.2018, e miratuar nga Qeveria dhe Udhëzuesi i brendshëm për procedurat dhe kriteret për njohjen e eksperteve që ofrojnë shërbimet profesionale dhe teknike për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues, nr. 01/2020, dt. 22.06.2020’. Ndër tjerash, ky zyrtar e thërret takimin e komisionit për licenca, përgatit rekomandimin nga komisioni për drejtorin e përgjithshëm dhe licencën të cilën duhet ta nënshkruaje drejtori. Pas nënshkrimit të licencës, zyrtari e informon palën për vendimin përfundimtar në lidhje me licencimin;

- Procesi i licencimit nuk është një proces konkurrues as përzgjedhës. Është një vlerësim teknik i kriterëve të cilat aplikanti duhet t'i plotësoj. Në bazë të plotësimit të këtyre kriterëve rekomandohet dhënia apo mos dhënia e licencës. Kriteret janë të listuara në shtojcën e formularit të aplikacionit për secilën veprimtari...]¹".

Pas vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit me rastin e nënshkrimit të licencave për subjektet aplikuese nga z. Naser Balaj në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve për Licenca, Autorizime dhe Leje.

Kjo për faktin se, siç është theksuar mësipër, në dy rastet e nënshkrimit të licencave të subjekteve përkatëse, z. Naser Balaj ka qenë paraprakisht i autorizuar si ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm. Ndërsa, sikurse është sqaruar në deklaratën e palës, procesi i licencimit nuk është një proces konkurrues apo përzgjedhës, por një vlerësim teknik i kriterëve dhe varësisht nga (mos)plotësimi i këtyre kriterëve rekomandohet dhënia apo mos dhënia e licencës. Pra, për arsye e cekura mësipër, procesi i shqyrtimit të aplikacioneve dhe rekomandimi për licencim për subjektin aplikues, nuk lë hapësirë për vlerësim subjektiv nga ana e komisionit, ndërsa nënshkrimi i licencës më pas, paraqitet të jetë vetëm formalizim i rekomandimit të komisionit.

Në këtë kontekst, nënshkrimi i (dy) licencave në rastin konkret nga z. Naser Balaj në cilësinë Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve për Licenca, Autorizime dhe Leje, duke qenë i autorizuar të ushtrij detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMRrSB-së, është parasëgjithash përmbushje e obligimit ligjor, përkatësisht, ushtrim i kompetencës/detyrës së dhënë me autorizim paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMRrSB-së, dhe se cilido nga anëtarët e komisionit që të nënshkruante licencat, do të gjendej para situatës së njëjtë, prandaj kjo situatë si i tillë nuk mund të konsiderohet si vendimmarrje me interes privat, në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (nenit 17, në lidhje me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.2 dhe 1.12).

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshka
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

¹ Dokumentacioni dhe përgjigjet (deklaratat) e siguruar nga z. Naser Balaj dërguar Agjencisë përmes menaxhmentit të AKMRrSB-së.